

Vendim nr. 266 datë 11.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 11.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Z) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ZAMIR HOXHA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-762, datë 29.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 33, 35, 42, 49, 57, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe nenet 6, 8 dhe 2 të Protokollit Shtesë të saj; nenet 2, 20, 21 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Zamir Hoxha ka punuar në detyra të ndryshme në Gardën e Republikës së Shqipërisë prej vitit 1997. Në vitin 2007 ai ka kaluar në detyrën e Trupës së Shërbimit në

Njësinë e Parë të Gardës së Republikës. Me urdhrin nr.487, datë 15.07.2009 (*urdhri nr. 487/2009*) të Komandantit të Gardës së Republikës, kërkuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për thyerje të përsëritur të disiplinës në punë.

2. Duke mos qenë dakord me largimin nga detyra, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, me objekt shpërblimin e dëmit për mosrespektimin e afateve dhe procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara sipas Kodit të Punës.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3811, datë 10.05.2010, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke shfuqizuar aktin e liritimit nga detyra, si dhe duke detyruar Gardën e Republikës t'i paguajë kërkuesit shpërblim në masën e pagës së një viti pune për zgjidhjen e kontratës së punës, në kundërshtim me nenin 144 të Kodit të Punës. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1635, datë 11.07.2011, por me arsyetim të ndryshëm, konkretisht se zgjidhja e kontratës së punës ishte pa shkaqe të justifikuara, në shkelje të nenit 153 të Kodit të Punës. Ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 3527, datë 13.11.2014, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga të dyja palët.

4. Në datën 26.02.2016 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore, duke i bashkëngjitur kërkesës disa akte të dosjes personale të punës, me pretendimin se ishin prova të reja të rëndësishme për çështjen, të cilat nuk ishin marrë në konsideratë në gjykimin e mëparshëm. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-762, datë 29.02.2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se aktet e paraqitura nga kërkuesi nuk përbënin prova të reja që lejonin rishikimin, në kuptim të nenit 494/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

5. Në datën 31.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 09.08.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

6.1.1. *Parimit të gjykatës së paanshme*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e kërkesës për rishikimin është kundër jurisprudencës kushtetuese.

6.1.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar provat e paraqitura për rishikimin e vendimeve, të cilat nuk kanë qenë pjesë e dosjes

gjqësore në gjykimin e parë, ndaj ish-in prova të reja. Në rastin e kërkuetit, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet të ndryshonte vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi binte ndesh me të drejtën dhe ligjin.

6.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në vlerësim provat e reja që kishin rëndësi për çështjen, të cilat nuk janë përdorur në gjykimet e mëparshme në të tria nivelet, si dhe ato nuk gjejnë pasqyrim në vendimin e tij. Me anë të provave të dorëzuara rishtazi vërtetohet haptazi se nuk ka asnjë shënim në librat e shërbimit, armatimit dhe planëzimit në lidhje me masën disiplinore të dhënë ndaj kërkuetit, si dhe as procesverbal komunikimi, siç parashikohet në rregulloren e Gardës së Republikës. Pra, në bazë të këtyre provave vërtetohet se kërkueti nuk ka kryer shkelje disiplinore, siç pretendon punëdhënësi, për rrjedhojë nuk duhej liruar nga detyra me masë disiplinore. Kërkueti e ka konstatuar këtë fakt vetëm pasi është njohur me aktin e lirimit nga detyra e jo më herët. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë shqyrtuar çështjen e kërkuetit, kur ai është larguar nga puna, bazuar në dispozitat e Kodit të Punës dhe jo në bazë të ligjit nr. 8869, datë 22.05.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit parashikohet rikthimi në punë, nëse vendimi për lirim nga detyra është i padrejtë.

6.2. *E drejta për të fituar mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë*, e garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, pasi marrëdhënia e punës është ndërprerë në mënyrë të padrejtë dhe në shkelje të normave të së drejtës. Nuk është mbajtur asnjë procesverbal për masë ndëshkimore në prani të kërkuetit dhe komisioni i disiplinës nuk e ka marrë në shqyrtim ankesën e tij në lidhje me urdhrin e Komandantit të Gardës së Republikës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual,

në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, pasi procesi gjyqësor është përmbyllur në Gjykatën e Lartë, ndaj ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, vendimi gjyqësor që kundërshtohet nga kërkuesi mban datën 29.02.2024 dhe është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 12.04.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 31.07.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

12. Në drejtim të legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së paanshme, me argumentin se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e kërkesës për rishikimin bie ndesh me jurisprudencën kushtetuese, duke paraqitur disa citime nga vendimet e Gjykatës. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë fakt konkret, që të vërë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve që kanë shqyrtuar çështjen e tij, vlerëson se citimi i jurisprudencës kushtetuese është i pamjaftueshëm për të mbështetur këtë pretendim, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të sigurisë juridike, të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si aspekte të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të

ligjshme, të garantuar nga neni 49 i saj. Për të mbështetur këto pretendime, ai ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk ka marrë në vlerësim provat e reja që kishin rëndësi për çështjen, të cilat nuk janë përdorur në gjykimet e mëparshëm në të tria nivelet, si dhe ato nuk gjejnë pasqyrim në vendimin e tij. Sipas tij, me anë të provave të dorëzuara rishtazi vërtetohet haptazi se nuk ka asnjë shënim në librat e shërbimit, armatimit dhe planëzimit në lidhje me masën disiplinore të dhënë ndaj kërkuesit, si dhe as procesverbal komunikimi, siç parashikohet në rregulloren e Gardës së Republikës, ndaj vërtetohet se nuk ka kryer shkelje disiplinore dhe marrëdhënia e punës është ndërprerë në mënyrë të padrejtë.

14. Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Duke iu kthyer rastit konkret, referuar akteve shkresore të paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të kërkesës, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të tij, me arsyetimin se ajo ishte bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 të KPC-së dhe se prova e paraqitur si “*e re*” nga pala kërkuese, e cila konsistonte në librat e shërbimit të datave 10.01.2008 dhe 16.02.2008, librit të armatimit të datës 08.04.2008, si dhe librave të planëzimit të datave 08.04.2008 dhe 28.06.2009, nuk mund të shërbente si e tillë për rishikimin e vendimit, në kuptim të nenit 494/a të KPC-së. Po sipas Gjykatës së Lartë, provat që pretendohen si të reja nga kërkuesi janë akte të dosjes së tij personale dhe për më tepër nuk kanë asnjë rëndësi për çështjen, në kushtet kur gjykatat e zakonshme e kanë quajtur të paligjshme masën disiplinore dhe kanë shfuqizuar urdhrin e përjashtimit, duke i dhënë atij edhe shpërblimin përkatës me vendim të formës së prerë (*shih paragrafët 26 dhe 28 të vendimit nr. 00-2024-762, datë 29.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

16. Për sa më lart, Kolegji çmon se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese, duke interpretuar ligjin në çështjen e kërkuesit, interpretim i cili

duket objektivisht i arsyeshëm dhe nuk bie ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet e ngritura nga kërkuesi kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të ligjit dhe, si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.